

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Drejtor, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (Kategoria II-b).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor (*ose të barazvlefshme me to*) (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ka për detyrë si më poshtë:

Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse varet nga Kryeinspektori dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Organizon, koordinon dhe drejton punën e drejtorisë nëpërmjet shpërndarjes së detyrave, kërkesës së llogarisë, marrjes së masave dhe paraqitjes së propozimeve;
2. Është përgjegjës për arritjen e objektivave afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të përcaktuara nga Kryeinspektori;
3. Bën shpërndarjen e punës dhe çështjeve që i adresohen Drejtorisë dhe ndjek e kontrollon punën që bëhet nga specialistët në varësi;
4. Kontrollon dhe firmos të gjithë shkresat në emër të Drejtorisë;

5. Ka të drejtën e propozimeve për ndryshimin e metodologjisë dhe procedurave të punës si dhe për marrjen e masave tekniko–organizative për çështje që lidhen me veprimtarinë e Drejtorisë;
6. Mban përgjegjësi për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për të gjithë automjetet e Institucionit si dhe për respektimin e tyre;
7. Menaxhon procesin e pagesës së taksave vjetore, kontrollit teknik dhe sigurimit motorrik të mjeteve;
8. Kontrollon në mënyrë sistematike dokumentacionin përkatës për të gjitha makineritë dhe ndjek shkallën e amortizimit të tyre;
9. Nënshkruan të gjitha aktet administrative shkresore që dalin nga sektori.

Dokumentat që aplikanti për Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë të nivelit Master Shkencor (*ose të barazvlefshme me to*), dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Vërtetim i aftë për punë;
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 16.02.2025.